

Përmbledhje

Simpoziumi për 'Smart City' në UBT



UBT – Qendra për Studime Urbane
Prill, 2019

Përmbledhje e Simpoziumit për ‘Smart City’, të mbajtur me date 05.04.2019 në kampusin inovativ të UBT-së në Lipjan

Çështja e qyteteve të mençura tashmë është bërë një temë globale, ndërsa për herë të pare në Kosovë një simpozium me një temë të tillë është organizuar nga UBT.

Pjesëmarrës në këtë organizim ishin profesorë të ndryshëm nga Austria, kryetarë komunash, drejtorë urbanizimi të komunave të ndryshme, si dhe profesorë e studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor nga UBT.



Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, në fjalën e tij hapëse duke treguar mbi rëndësinë e jetësimit të ideve mbi qytetet e mençura, tha se UBT për këtë qëllim ka themeluar Qendrën për Studime Urbane. “Është e rëndësishme që në këtë periudhë të rregullojmë qytetet tona, në mënyrë që të ketë ndikim në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, prandaj edhe fokusi i qendrës sonë, por edhe i këtij simpoziumi janë palët e interesit që kanë ndikim në implementimin e propozimeve dhe zgjidhjeve tona”, vlerësoi ai.

Pas fjalimeve hyrëse, simpoziumi ka vazhduar me punëtorë, të cilat i ndoqën studentët dhe profesorët e pranishëm, të ndarë në grupe.

Punëtorja “Dizajnimi i qyteteve të mençura dhe menaxhimi i arsimit” u mbajt nga rektori i UBT-së, Prof. Dr Edmond Hajrizi, i cili i trajtoi transformimin e teknologjisë dhe konvergencën si funksione që duhet të bashkëveprojnë mes vete për të pasur sukses.

Tema “Planifikimi i Mençur” u ligjërua nga ligjëruesi në Universitetin e Vjenës, Thomas Dillinger, i cili krahas njohurive teorike dha edhe shembull praktik nga një qytet i vogël austriak Ebreichsdorf, si model i ndërtimit të një qyteti të mençur.

Punëtorja “Jetesa e mençur” u mbajt nga eksperti shqiptar që vepron në Austri, Skender Kosumi, i cili u fokusua në idenë e ngritjes së cilësisë së jetës nëpër qytete, duke u bazuar në teknologji dhe thjeshtësi, si dhe duke siguruar fleksibilitet maksimal në hapësirat e banimit.

Hulumtuesi në IEEE International Forum, Hartmunt Dumke, i cili udhëhoqi punëtorinë “Planifikimi i Mençur i Energjisë”, prezantimin e tij e fokusoi në shfrytëzimin dhe planifikimin e mençur të energjisë.

Tryeza e rrumbullakët

Në tryezën e diskutimit të mbajtur pas prezantimeve/workshopeve përkatëse, u shtruan pyetje dhe u kërkuan rrugë, mënyra, qasje dhe strategji për tu marrë seriozisht dhe intenzivisht me çështjen e Qyteteve të Mencura, si një teme shumë pak e trajtuar por e domosdoshme për të gjitha qytetet dhe shoqëritë e epokës së informacionit dhe digjitalizimit.

Në tryezën e diskutimit, në mesin e të tjerëve morën pjesë edhe rektori i UBT-së Prof.Dr. Edmond Hajrizi, dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Dr. Lulzim Beqiri, Can.Dr. Skender Kosumi (bashke iniciator dhe koordinator i simpoziumit), udhëheqësi i Qendrës për Studime Urbane Shqiprim Ahmeti, Thomas Dillinger dhe Hartmut Dumke nga Instituti për Planifikim Hapësinor i Universitetit Teknik të Vjenës, profesorë dhe ekspertë të tjerë vendor si dhe nga Zvicra si Michael Locher dhe Christopher Pannett etj.



Rektori i UBT-së Prof.Dr. Edmond Hajrizi theksoi se reputacioni që gëzon UBT në nivel vendi dhe më gjerë, infrastruktura e ndërtuar deri më sot si dhe të gjitha resurset humane në të cilat mbështetet universiteti e kanë shtyrë këtë të fundit të marrë iniciativa dhe të aktualizojë tema me rëndësi të madhe mirëpo të patrajtuara paraprakisht, ndërsa inicimi i temës së Qyteteve të Mencura është vetëm njëra nga to. U theksua gjithashtu se, me qëllim që temës në fjalë ti dedikohet vëmendja dhe përkushtimi i merituar, UBT ka themeluar Qendrën për Studime Urbane, puna e së cilës do të bazohet në punë multidisiplinare duke përfshirë fushat si: planifikimi urban, arkitektura, dizajni, inxhinieria, shkencat kompjuterike, sociologjia dhe ekonomia, për tu fokusuar kështu në natyrën multidisiplinare të problemeve urbane dhe për të ofruar kërkime dhe aplikime që fuqizojnë qytetet tona për tu ofruar qytetarëve një ambient urban më të jetueshëm dhe një kualitet më të lartë të jetës.

Ai gjithashtu theksoi se, UBT është e fokusuar në shndërrimin e kampusit inovativ në një kampus të mencur (Smart Campus), si një miniaturë e funksionimit të hapësirave të mencura (Smart Areas).

Thomas Dillinger dhe Hartmut Dumke nga Instituti për Planifikim Hapësinor i Universitetit Teknik të Vjenës theksuan nevojën e bashkëpunimit me komunat dhe insitucionet të cilat kanë vullnet për punë, për të hulumtuar e më pastaj për të përpiluar strategjitë për qytetet e mencura në Kosovë, bazuar në praktikat më të mira europiane e botërore të cilat do të jenë pjesë e rëndësishme e fazës analizuese. Ndërsa në tërë këtë punë, studentët do të duhej të konsideroheshin/trajtoheshin si një aset shumë i rëndësishëm human.

Ata po ashtu kanë propozuar që të trajtohen deri në 5 qytete të madhësisë së mesme si pilot projekte, duke e ndarë këtë si mësim nga përvojat e tyre nga puna e bërë në Austri. I këtij mendimi ishte edhe dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Dr. Lulzim Beqiri, i cili propozoi përzgjedhjen e 2-3 qyteteve/komunave për tu realizuar vizita studimore. U theksua gjithashtu se trajtimi i qyteteve/komunave të vogla është mjaft i vështirë, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteve humane dhe financiare e cila i karakterizon ato. U porosit që, trajtimi i qyteteve të bëhet në varësi nga problemet me të cilat ato ballafaqohen dhe në varësi nga temat për të cilat ato kanë më së shumti nevojë dhe interes.

Sa i përket problemit të trafikut të Prishtinës u theksua nevoja për zgjidhje kreative, gjithëpërfshirëse dhe nevoja për përmirësimin e transportit publik. Këtu duhet të theksohet nevoja për një integrim të plotë të planifikimit të transportit me planifikimet e mirëfillta zhvillimore.

Përshtatja e kurrikulës me nevojën reale për të trajtuar çështjen e Smart City ishte një çështje tjetër me rëndësi e cila e ka karakterizuar debatin në këtë tryezë diskutimesh.